

Misioni i OSBE-së në Kosovë – njëvjetori i tij

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) është misioni i parë i këtij lloji. Ai është i veçantë në kompleksitetin dhe tërësinë e tij ku përfshihen organizata të ndryshme ndërkombëtare. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë – Misioni në Kosovë (OMIK), është organizata kryesuese në detyrat e UNMIK-ut për ndërtimin e institucioneve.

Misioni ishte themeluar nga Këshilli i Përhershëm i OSBE-së më 1 Korrik 1999 (Vendimi nr.305 i Këshillit të Përhershëm). Duke iu referuar Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ky Këshill vendosi që OSBE-ja, në strukturën e përgjithshme të UNMIK-ut, të "merr detyrën kryesore në çështjet që kanë të bëjnë me ndërtimin e institucioneve dhe demokracisë si dhe çështjet e të drejtave të njeriut". Sipas mandatit të tij, Misioni bashkëpunon me organizata të tjera relevante ndërqeveritare dhe ato joqeveritare në planifikimin dhe implementimin e detyrave të veta.

Për një vit në këtë Mision, OMIK-u ka arritur të bëhet një ndër degët më të rëndësishme të UNMIK-ut. Ai ka ngritur 18 zyre të terrenit dhe pesë qendra regjionale në gjithë Kosovën. OMIK-u pranon ndihmën dhe ekspertizën nga organizatat e tjera ndërkombëtare siç janë: Këshilli i Evropës dhe Misionet e tjera të OSBE-së në rajon. Misioni, deri në Maj të vitit 2000 është përbërë nga më tepër se 560 punonjës ndërkombëtarë dhe më tepër se 1470 anëtarë të ekipit lokal.

Udhëheqës i Misionit është Ambasadori Daan Everts (Holandë).

Demokratizimi

- Qendra për shërbime të partive politike të hapura në Prishtinë, Pejë, Mitrovicë dhe Skenderaj
- Diskutime të mbajtura në tryezat e rrumbullakëta të partive rajonale politike
- Këshilli i OJQ-ve lokale i themeluar
- Udhëzime të dhëna për regjistrimin e OJQ-ve dhe trajnimi për procedurat e regjistrimit të tyre i kryer
- Konferenca e Parë multi- etnike e grave e mbajtur
- Qendrat Përkrahëse të OJQ-ve të hapura në Pejë, Prishtinë dhe Prizren
- Të mbajtura kurse prezantuese për Administratorët lokal të Kombeve të Bashkuara.

Qëllimi i hapjes së katër Qendrave për shërbime të partive politike është që të avancohet zhvillimi i partive politike të mirëfillta dhe demokratike në Kosovë. OMIK-u e ka zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme kapacitetin operativ të këtyre qendrave. Janë zhvilluar disa seri të aktiviteteve për trajnimin e partive politike, të përqëndruara në çështjet e marrëdhënieve publike, rregullat kryesore për organizimin e partisë politike dhe zhvillimin e platformës së tyre.

Krahas punës me partitë politike, OMIK-u ka mbajtur kontakte me një numër të madh të përfaqësuesve të OJQ-ve dhe me anëtarë të tjerë të shoqërisë civile në Kosovë. Momentalisht

është duke u zhvilluar një program për zhvillimin e OJQ-ve lokale, që përfshinë përkrahje materiale e logjistike si dhe përkrahje në krijimin e kapaciteteve dhe përparimin e aftësive për krijimin e fondeve nëpërmjet bazave logjistike të Qendrave Përkrahëse të OJQ-ve, me theks të veçantë në grupet e grave, të të hendikepuarve dhe grupe të rinjëve. OMIK-u ka përgaditur një skicë kushtetuese për themelimin e Këshillit të OJQ-ve të Kosovës. Ai gjithashtu e ka ndihmuar mbledhjen e parë të OJQ-ve në Kosovë. Misioni ka vërejtur se nevojë primare është zhvillimi i shoqërisë civile brenda komuniteteve të ndryshme në Kosovë dhe mundohet t'i përmbushë nevojat e tyre urgjente për avancimin e pjesëmarrjes publike dhe aktiviteteve të qytetarëve.

Pikësnyimi më i madh i Përhrahjes së Administratës Civile është që të forcohen posaçërisht strukturat lokale të qeverisjes në Kosovë. Për këtë respekt, OMIK-u ka krijuar Institutin për Administrim Civil i cili ka ofruar trajnim për personelin e komunave që nga Dhjetori i vitit 1999, që janë mbajtur me tema të ndryshme si: Administrimi i Personelit, Rregullat e Demokracisë Lokale dhe Vetëdijësimi për të Drejtat e Njeriut apo Administrimi dhe Kontrollimi i Buxhetit dhe Pjesëmarrja e Qytetarëve. Deri më tani në më shumë se 40 seminare të mbajtura, janë trajnuar rreth 500 anëtarë të personellëve të tillë.

Të drejtat e njeriut

- Fillimi i Programit për Zyrarët Kombëtarë të të drejtave të njeriut
- Zhvillimi i trajnimit për të drejtat e njeriut në mbarë Kosovën
- Raportim/vlerësim i hollësishëm dhe i vazhdueshëm për situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë (duke përfshirë edhe sistemin juridik dhe zgjedhjet)
- Avancimi i iniciativave të pajtimit
- Integrimi i të drejtave të njeriut në institucione të reja
- Zhvillimi i kapaciteteve për hulumtimin e rasteve të personave të humbur dhe identifikimin e kufomave
- Bashkërendim i vazhdueshëm me UNHCR-në, ICRC-në dhe TNKLJ-në (Tribunali Ndërkombëtar për krime lufte në ish-Jugosllavi)

Komponentja kryesore për programin e krijimit të kapaciteteve për të drejtat e njeriut ka filluar në Prill të vitit 2000, me caktimin e 8 Zyrarëve Kombëtarë për të Drejtat e Njeriut (ZKDNJ), të cilët janë trajnuar gjerësisht dhe janë integruar në punën e Misionit. OMIK-u e ka vazhduar raportimin/vlerësimin e hollësishëm për të drejtat e njeriut në Kosovë, i cili është zgjeruar me qëllim që të përfshijë edhe mbikqyrjen sistematike të sistemit juridik dhe zgjedhjeve. Në bashkëpunim me UNHCR-në janë publikuar katër vlerësime për situatën e minoriteteve. Avancimi i mbrojtjes afatgjate të të drejtave të njeriut është rritur, përfshirë këtu edhe një program trajnimi të zgjeruar, avancimin e projekteve për pajtim si dhe integrimin e çështjeve të të drejtave të njeriut në institucione. OMIK-u ka filluar një program substancial për të shtjelluar çështjen e Personave të Humbur, duke përfshirë këtu edhe ndihmën që duhet dhënë UNMIK-ut dhe TNKLJ-së për identifikimin e kufomave dhe zhvillimin e kapaciteteve lokale në këtë vend.

Sundimi i ligjit

- Ofrimi i informatave gjatë seleksionimit të gjyqtarëve e prokurorëve dhe trajnimit i të emëruarve
- Përgatitjet për Zyrën e Ombudsmanit së bashku me partnerët e tjerë ndërkombëtarë
- Ofrimi i përkrahjes për komunitetet legale
- Përgatitja e Qendrës Juridike të Kosovës
- Ofrimi i ndihmës dhe përkrahjes për Shkollën Juridike të Prishtinës
- Përkrahja materiale për gjyqë

OMIK-u dhe degët e Administratës Civile të KB-së vazhdojnë të punojnë së bashku në sistemin juridik. Janë mbajtur simpoziume trajnuese për gjyqtarët lokal të sapoemëruar, prokurorët dhe avokatët. Është mbajtur xhironja e dytë e kurseve prezantuese në të gjitha rajonet. Janë ofruar tri

vëllime të materialeve për qëllime të trajnimit. Gjithashtu edhe Qendra Juridike e Kosovës ka publikuar një përmbledhje të ligjeve aplikuese për krime. Me themelimin e Institutit Juridik të Kosovës, trajnimi përqëndrohet në tema më specifike të drejtuar në grupe më të vogla. Sektori për Përkrahje të Komuniteteve Legale, ka kompletuar një vlerësim të nevojave të komuniteteve legale lokale dhe ka ofruar ndihmë në organizimin e Kuvendit të Përgjithshëm të Shoqatës së Avokatëve të Kosovës. Ngjarja që pasoi ishte një sukses i madh sepse u arrit përrshirja e minoriteteve në borde të ndryshme. Sektori i Ombudspersonit për Përkrahje ka hartuar dhe propozuar një rregullore për themelimin e zyrës, që momentalisht është nën konsideratë. Gjithashtu është në përgatitje edhe një fushatë e informimit publik.

Edukimi policor dhe zhvillimi

- Krijimi i programit mësimor për Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK)
- SHSHPK-ja është institucioni i vetëm multi-etnik që funksionon momentalisht në Kosovë
- Tani për tani në këtë shkollë po i ndjekin mësimet dy klasë, me gjithsej 606 studentë.

Përparim substancial është arritur në zhvillimin e Shërbimit të ardhshëm Policor të Kosovës (SHPK). OSBE-ja e ka mandatin të trajnojë në Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës, mesatarisht 3.500 studentë të rekrutuar lokalë, të cilët brenda 18 muajve do të punojnë si shërbim policor i orientuar kah komunitetet, në mënyrë që të fitohet besimi në zbatimin e ligjit tek qytetarët e Kosovës. Shkolla, që momentalisht përbëhet nga 200 instruktorë ndërkombëtarë të cilët ndihmohen nga ekspertët kosovarë, pat hapur dyert e veta për studentët e parë, në Shtator të vitit 1999. Deri në fund të muajit Maj të vitit 2000, katër klasë – apo gjithsej 794 studentë – kanë diplomuar në Shkollën e Policisë. Klasa e pestë me 287 studentë, do të diplomojë tani në Qershor, derisa klasa e gjashtë me 322 kadetë tashmë ka filluar trajnimin themelor.

Përpjekje të jashtëzakonshme janë bërë për t'u siguruar përfaqësimi i drejtë i të gjitha minoriteteve: në gjashtë klasët e para të SHSHPK-së, 6% janë serbë të Kosovës dhe 5.5% janë nga komunitetet jo-shqiptare, përdërisa 17% janë femra.

OSBE-ja gjithashtu ka zhvilluar një Kurs për Trajnimin e Zyrarëve të Terrenit (TZT) që i dedikohet zyrtarëve të policisë ndërkombëtare të UNMIK-ut. Ky kurs dyditor në Shkollën e Policisë është dizajnuar për t'i ndihmuar zyrtarët ndërkombëtarë në rolin e tyre si trajnerë për krijimin e kapaciteteve. Që nga Tetori i vitit 1999, më tepër se 1500 TZT të UNMIK-ut e kanë mbaruar kursin. Në të ardhmen, OSBE-ja gjithashtu planifikon që të zhvillojë dhe udhëheqë mbikqyrjen dhe administrimin e kurseve të trajnimit të policëve, për gati 700 oficerë eprorë të zgjedhur nga Shërbimi Policor i Kosovës.

Regjistrimi civil dhe zgjedhjet

- Një Ekip i Përbashkët i Regjistrimit (EPR) – i themeluar në bazë të një marrëveshjeje në mes të degës së dytë të UNMIK-ut (Administrata Civile) dhe degës së tretë (ndërtimi i institucioneve nga OSBE-ja) dhe është përgjegjës për regjistrimin civil dhe votues
- Vlerësohet se diku në mes 1 dhe 1.5 milion persona do të regjistrohen gjatë periudhës tre-mujore
- Deri në fund të Majit, rreth 193 Qendra të Regjistrimit janë funksionale dhe rreth 350.000 aplikacione të paraqitura. Si rrjedhojë e këtyre, rreth 35.000 raste janë në procesin e rishikimit (deri me këtë datë, është gjetur dokumentacion për më shumë se 60% të rasteve të tilla)
- Regjistrimi jashtë Kosovës ka filluar në mënyrë të njëpasnjëshme në 32 shtete – me postë, dhe në Mal të Zi, Shqipëri dhe në Maqedoni – personalisht
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i themeluar në bazë të rregullores Nr.2000/21, do të vendosë për strukturën rregullative të zgjedhjeve komunale

Qëllimi i regjistrimit civil është identifikimi i banorëve të Kosovës që do të kërkojnë shërbime nga Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara. Ky regjistrim gjithashtu do të jetë edhe bazë për Regjistrin e Votuesve për Zgjedhjet Komunale që do të mbahen në Tetor të vitit 2000 në tridhjetë komuna në Kosovë.

EPR-ja filloi Regjistrimin Civil (fazën e parë, ku regjistrohen personat mbi moshën 16-vjeçare) më 17 Prill dhe ky proces po kryhet në 200 qendra të regjistrimit anembanë Kosovës dhe do të zgjasë deri kah gjysma e Korrikut. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është trupi kryesor rregullues i procesit të zgjedhjeve dhe përbëhet nga 3 persona ndërkombëtarë dhe 9 lokalë. Ky trup deri më tani veç ka adaptuar 7 Rregulla Zgjedhore për zgjedhjet e ardhshme komunale. Këto përfshinë edhe Kodin e Sjelljes për Partitë Politike, Koalicionet, Kandidatët dhe Iniciativat Qytetare, si dhe marrjen e Çertifikatave të tyre për votim. Në mënyrë që partitë politike të mbeten të informuara për të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me përgatitjet zgjedhore, është krijuar gjithashtu edhe Forumi Konsultativ për Partitë Politike (FKPP).

Çështjet e mediave

- Komisioneri i Përkohshëm i Mediave i emëruar për t'u dhënë leje emetuesve
- Është themeluar Radio Televizioni i Kosovës (RTK)
- Zhvillimi i Rregullores së Emetimit që do të krijojë një Komision të Përkohshëm të Mediave përfshirë këtu edhe përpjekjet për krijimin e mekanizmit vetë-rregullues
- Është themeluar Fondi Rezervë për t'u ofruar ndihmë mediave

- Aktivitete të koordinuara të donatorëve, përfshirë edhe mbledhjet e zakonshme dhe 14.5 milion \$ nga Qeveria Japoneze për RTK-në dhe sitemin tokësorë të transmetimit

Nën mandatin e vet, OMIK-u kontribuon në përcaktimet që mbështesin lirinë e shtypit dhe të informimit në Kosovë, me mundësinë që gazetarët të ushtrorjnë të lirë profesionin e vet.

Drejtori i OMIK-ut për çështje të mediave është emëruar nga z. Bernard Kushner, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Kombeve të Bashkuara, si Komisioner i Përkohshëm i Mediave. I varur nga aprovimi i UNMIK-ut për rregulloren e përkohshme, ai do të ketë kompetencat që të jap leje për emetuesit dhe do të ndërmarrë aksione kundër emetuesve ilegal dhe atyre që i kanë lejet por që e shkelin kodin e emetimit. Ky kod është adaptuar në konsultime të ngushta me UNMIK-un, Këshillin e Evropës dhe ekspertë të tjerë juridik, si dhe me Bordin Këshillues për Politikën e Mediave Kosovare. OMIK-ut gjithashtu i është caktuar detyra për themelimin e një sistemi të pavarur publik, Radio Televizionit të Kosovës (RTK) RTK-ja, që filloi me programin e saj të parë televiziv më 19 Shtator, që gëzon përkrahje lokale gjithnjë në rritje dhe miratimin ndërkombëtar. OMIK-u ka qenë në gjendje që të sigurojë një fond të konsiderueshëm për zhvillimin e RTK-së dhe mediave private.

Përpjekje intensive janë në rrugë e sipër, për transformimin e Ndërtesës së Rilindjes në Shtëpi të Mediave, me disa përmirësime që duken qysh tani, por mbeten akoma disa probleme që gjithashtu duhet të zgjidhen.

Do të mbahen seri të programeve trajnuese për gazetarë në bashkëpunim me donatorët. Këto programe që janë në rritje e sipër po përqëndrohen në gazetari të drejtë dhe të balancuar gjatë fushatave zgjedhore.